V E N D I M
Nr.175, datë 25.4.1994

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.479, DATË 16.9.1993 "PËR DISA NDRYSHIME NE VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.276, DATË 3O.6.1992 "PËR ORGANIZIMIN, PRITJEN, SHPËRNDARJEN DHE ADMINISTRIMIN E NDIHMAVE SHTETERORE""

Me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë e të Ushqimit dhe të Ministrisë së Industrisë e Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.479, datë 16.9.1993 "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.276, datë 3O.6.1992 "Për organizimin, pritjen, shpërndarjen dhe administrimin e ndihmave shtetërore"", në kreun II, në pikën 2, bëhen këto ndryshime:

- Paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Tregshumi në Durrës kryen shitjen me shumicë të artikujve ushqimorë, me përjashtim të orizit, subjekteve të ndryshme nëpërmjet ankandit, sipas ushëzimit të Këshillit të Ministrave për prokurimin".

- Paragrafi i tretë të ndryshohet si vijon:

"NTG në Durrës realizon shitjen e artikullit grurë për subjektet shtetërore e private dhe miell vetëm për subjektet shtetërore, me çmime sipas atyre të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.273, datë 12.6.1993, pika 1, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.49O, datë 18.1O.1993. Për subjektet private përdoruese të miellit shitja bëhet vetëm në ankand sipas udhëzimit të Këshillit të Ministrave për prokurimin".

2. Këto ndryshime për artikullin e grurit të zbatohen gjer me 1 korrik 1994, kurse për atë të orizit deri në përfundimin e shitjes së gjëndjes që rezulton me 3O.4.1994 për gjendjen në të gjitha ndërmarrjet tregtare shtetërore me shumicë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi